



PROF. ASOC. DR. ROZI KOSTANI

Prof. Asoc. Dr. Rozi Kostani është aktore, regjisore dhe pedagoge me një karrierë të konsoliduar artistike dhe akademike. Prej 26 vitesh kontribuon në formimin e brezave të rinj të artistëve në Universitetin e Arteve, duke ndërthurur pedagogjinë me angazhimin e vazhdueshëm në teatër, film dhe kërkim shkencor.

Me specializime ndërkombëtare në Romë dhe Liban, ajo ka ndërtuar një profil të spikatur artistik, me mbi 60 role në teatër dhe kinematografi dhe mbi 15 shfaqje teatrore të realizuara si regjisore.

Rozi Kostani është Master në Regji dhe Doktore e Shkencave në Histori Arti. Veprimtaria e saj karakterizohet nga kërkimi artistik, qasja bashkëkohore ndaj gjuhës skenike dhe angazhimi për tema me rëndësi sociale, kulturore dhe edukative.